

VENDIM
Nr.972, datë 1.12.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË
FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR DISA PROCEDURA
PROKURIMI, TË KRYERA NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT,
MINISTRIA E DREJTËSISË, RADIOTELEVIZIONI SHQIPTAR DHE ZYRA E
ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1 datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit e të institucioneve të saj të varësisë, si autoritete kontraktore, për të proceduar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit publik, me objekt “Blerje bojë vijëzimi, fosfor, diluent për DRMFT-në”. Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Lejimin e Radiotelevizionit Shqiptar, si autoritet kontraktor, për të proceduar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit publik, me objekt “Blerje projektori dhe pajisjesh për përdorim në studio të TVSH-së”. Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

3. Lejimin e Ministrisë së Drejtësisë e të institucioneve të saj të vartësisë si autoritete kontraktore, për të proceduar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit publik për zhvendosjen e linjës së tensionit të lartë nga territori ku po ndërtohet paraburgimi i Elbasanit. Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

4. Lejimin e gjykatave respektive, si autoritete kontraktore, për të proceduar normalisht dhe për të përfunduar, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit publik, me objekt:

- Rikonstrukcioni i mjediseve në Gjykatën e Lartë;
- Krijimi i mjedisit të shërbimit ndaj publikut në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
- Hartimi i projektit për rikonstrukcionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë;

- Hartimi i projektit për rikonstrukcionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pukë.
Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Drejtësisë, institucionet e tyre të varësisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha